



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 40

Prishtinë, më 19 mars 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N- 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi- kryetar i Komisionit, Behar Selimi – nënkryetar, Arsim Bajrami, Halit Krasniqi, Ardian Gjini, Amir Ahmeti, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Haki Demolli, Mufera Şinik dhe Jasmina Zhivković.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Rexhep Gashi – ekspert; Lavdim Krasniqi - Instituti Gjyqësor i Kosovës; Fjolla Uka – NDI; Arton Demhasaj dhe Lorik Bajrami – “Çohu” ; Suzana Pllana – IGJK; Beth Sreenan dhe Etrur Maloku – US Embassy; Dren Selimi – ICO; Charles Newcomb – ICO; Jeton Bytyqi – OSBE; Artan Canhasi – EULEX; Fixhrije Dragaj – asistente e GP të AAK-së; Fjolla Krasniqi dhe Fitore Sadiku – praktikantë.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi- kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.02.2012;
3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të grupit të punës në Projektkodin penal të Republikës së Kosovës;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat nr. 03/L-222;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-098 për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-168 për Turizmin dhe shërbimet turistike,
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës;
8. Shqyrtimi i raportit vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011;

9. Shqyrtimi i strategjisë dhe Planit të veprimit kundër korrupsionit për vitin 2012-2016;
10. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, propozoi që të fillohet me pikën e tetë të rendit të ditës, pasi që kemi prezent drejtorin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, për ta paraqitur raportin e punës për vitin 2011. Pika gjashtë dhe nëntë, të hiqet nga rendi ditës, sepse strategjia dhe plani i veprimit kundër korrupsionit për vitin 2012-2016, është shqyrtuar në mbledhjen e kaluar dhe është vendos të procedohet për shqyrtim në Kuvend.

Rendi ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.02.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 13. 02. 2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011

Lavdim Krasniqi – Prezantoi dhe paraqiti të arriturat e Institutit gjatë vitit 2011. Ai shpjegoi aktivitetet kryesore të Institutit, ndërsa në fokus të aktiviteteve ka qenë ngritja e kapaciteteve profesionale për gjyqtarë dhe prokurorë, ku po bëhet arsimim ligjor. Sfidat kryesore ishin realizimi i programeve trajnuese, ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve, veçanërisht nga drejta penale, drejtësia për të mitur, nga drejta civile, e drejta tregtare, sjella etike dhe profesionale, si dhe tema të tjera. Numri më i madh i aktiviteteve gjatë këtij viti ka qenë nga lëmi civil dhe penal. Pjesëmarrja e gjyqtarëve ka qenë më e madhe sesa e prokurorëve. Po ashtu, ndër sfidat kryesore ka qenë edhe trajnimi i dy gjeneratave për gjyqtarë dhe prokurorë, përgatitja dhe informimi sa më i detajuar rreth zbatimit të Ligjit për gjykata, që pritet të hyjë në fuqi më 1 janar 2013, vizitat studimore të organizuara për pjesëmarrës brenda dhe jashtë vendit, përgatitjen e provimit vlerësues etj.

Halit Krasniqi- E vlerësoi punën e Institutit, duke shtuar se është një nga raportet më të përgatitura si për nga forma, ashtu dhe për nga përmbajtja që deri më tani ka ardhur në këtë Komision.

Armend Zemaj- Pyeti: A keni ndonjë informacion sa i përket efektit të trajnimit për prokurorë, sepse jemi dëshmitarë që të gjitha rastet e vështira udhëhiqen nga prokurorët e EULX-it, ku qëndron esenca e avancimit, nëse nuk udhëhiqen rastet e vështira nga ana e prokurorëve vendorë ?

Arben Gashi – Tha se raporti për nga forma strukturore ka përmasim, mirëpo jemi të vetëdijshëm se kualitetin e drejtësisë e bën gjykata, që është edhe elementi kryesor që e vlerëson punën ose mospunën e gjyqtarëve dhe prokurorëve, e që rezulton nga kualiteti i shërbimeve të drejtësisë. Ne jemi në dijeni për rolin e këtij Institucioni që ju nuk mund të ndikoni në mënyrë të drejtpërdrejt, mirëpo fatkeqësisht, nga gjendja aktuale mund të themi se edukimi nuk po jep shumë rezultat, si pasojë e vet sistemit apo edhe e mënyrës së edukimit.

Haki Demolli- Vlerësoi se ka përmirësime në strukturën e raportit, mirëpo ai mendon se është shumë i detajuar në disa pjesë. Pyeti: Si është sajuar programi i trajnimit për avancim, a ka bashkëpunuar Instituti me trajnuesit dhe cilat kanë qenë kriteret për të qenë pjesë e programit?

Ardian Gjini- Tha se situata lidhur me sundimin e Ligjit në Kosovë, duhet t'i atribuohet të gjitha hallkave, jo vetëm njëres pre tyre, pavarësisht çfarë raporti ka ardhur. Mendoj se është mirë për të shprehur brengën rreth sundimit të ligjit në Kosovë. Këtë po e shpreh në emrin tim dhe në emër të Aleancës. Instituti Gjyqësor i Kosovës është krijuar me synim që ta sofistikojë, dhe jo ta ndërtojë sistemimin e zbatimit të Ligjit në Kosovë. Nuk mund të funksionojë sistemi i sundimit të ligjit në gjyqësor nëse nuk funksionon pjesa vitale e tij.

Arsim Bajrami- Duke u ndërlidhur me parafolësit, tha se kjo është vetëm një hallkë e këtij sistemi, ka shumë hallka për të siguruar një sistem të pavarur për funksionimin e drejtë të gjyqësorit. Mendoj se një rol të rëndësishëm e luan edhe një administratë profesionale. Sugjerim konkret për Institutin është që në përputhshmëri me kapacitet e tyre, të vazhdojnë edhe me trajnime për administratën.

Albulena Haxhiu- Nuk kam pasur shumë mundësi ta analizojë raportin, mirëpo kam vërejtur se ka pasur përmirësime. E vlerësoi pozitivisht punën e Institutit.

Pyetjeve të anëtarëve të Komisionit iu përgjigj Lavdim Krasniqi.

Kryetari, konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet Raporti i punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2011.

4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të grupit të punës në Projektkodin penal të Republikës së Kosovës

Behar Selimi- Në cilësi të kryesuesit të grupit të punës, e njoftoi Komisionin me punën që ka bërë grupi në përgatitjen e propozimamendamenteve. Ai sqaroi pse amendamentet e propozuara nga deputetja Alma Lama dhe Bekim Haxhiu, nuk janë mbështetur nga grupi i punës, përveç amendamentit të deputetes Alma Lama për heqjen e nenit 37, i cili është përkrahur. Tha se është punuar shumë në këtë grup, megjithatë ka ngelur të diskutohen amendamentet e propozuara nga prof. Arsim Bajrami.

Arsim Bajrami- Tha se amendamentet që kam propozuar, duhet të merren parasysh, sepse janë të përcaktuara rastet kur presidenti mund të kryejë veprë penale, për shembull, tradhtia ndaj vendit. Tradhtia ndaj vendit është paraparë edhe në procesin e amendamentimit të Kushtetues, sepse sa i përket të drejtave dhe përgjegjësi të presidentit, tradhtia ndaj shtetit cilësohet si formë e rëndë e veprës penale.

Albulena Haxhiu- I përkrahu amendamentet e propozuara nga grupi i punës, duke shtuar se edhe amnistia do të duhej të përfshihej në këtë kod dhe nuk e di pse është hequr. Po ashtu, propozoi që amendamenti për nenin 410 "Thirrja për rezistencë", të hiqet.

Ardian Gjini- Duke folur për nenin 37 të Projektkodit, tha se ka qenë i pranishëm presioni i medias gjatë gjithë kohës dhe kjo çështje nuk është studiuar si duhet. Mendoj se tërë procesi ka pasur qasje të gabueshme.

Armend Zemaj- Duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësit për nenin 37, tha se personalisht mund të them se më ka penguar interesimi vetëm për këtë çështje, ndërsa për krime të rënda nuk ka pasur interesim. Presioni i mediave ka qenë i paanalizuar, fatkeqësisht mendoj se pasojat do të vërehen në të ardhmen.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit për Legjislacion.

II. I rekomandohet Kuvendit të Kosovës për miratimin e Projektkodit penal të Republikës së Kosovës, me amendamentet e propozuara.

III. Amendamentet e miratuara dhe ato të cilat nuk janë mbështetur nga Komisioni, janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat nr. 03/ L-222,

Kryetari- Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-102, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat nr. 03/ L-222. Ai tha se ky Projektligj është hequr njëherë nga rendi ditës, pra që të analizohet dhe pasi të marrim sqarimet e nevojshme, të japim vlerësimin si Komision. Ju i keni marrë me kohë komentet e administratës, në të cilat është vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara, nuk kanë bazë që të procedohen për shqyrtim dhe miratim. Ai tha se ky Projektligj është në kundërshtim me Ligjin e procedurës administrative, Ligjin për konfliktet administrative dhe Ligjin për gjykatat.

Në momentin e votimit, prezent ishin 8 deputetë.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion me 5 vota për dhe 3 kundër, nxori këtë

Përfundim

Komisioni për Legjislacion vendosi që Komisionit Funkcional t'i dërgojë raport me konstatimin se projektligji dhe amendamentet e Komisionit Funkcional, nuk kanë bazë juridike për t'u proceduar për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës

Kryetari- Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për fondet pensionale të Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-098 për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror

Kryetari- Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-098 për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit FunkSIONAL, e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

8. Të ndryshme

Caktohet Nerxhivane Dauti ekspert në projektligjin për marrëdhëniet e detyrimeve.

Mbledhja përfundoi në orën 12:35.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi

Aneks

Amendamentet në Projektkodin penal të Republikës së Kosovës.

Amendamenti 1

Neni 1, riformulohet titulli si vijon: **“Bazat dhe kufijtë e sanksioneve penale”**

Amendamenti 2

Neni 4, paragrafi 2, riformulohet si vijon: **“Masat e trajtimit të detyrueshëm, të cilat mund t’i shqiptohen kryesit që nuk është penalisht i përgjegjshëm ose është i varur nga droga, ose nga alkooli, janë:”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 3

Neni 14, paragrafi 1, në rreshtin e fundit, pas fjalës: **“penale”**, shtohen fjalët: **“vetëm nëse personi menjëherë pas pushimit të rrezikut e lajmëron shtrëngimin dhe veprën e kundërligjshme tek organet kompetente.”**

dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 2, në rreshtin e fundit, pas fjalës: **“zbutet”** shtohen fjalët: **“vetëm nëse personi menjëherë pas pushimit të rrezikut e lajmëron shtrëngimin dhe veprën e kundërligjshme tek organet kompetente.”**

dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 4

Neni 16, paragrafi 2, në rreshtin e fundit, hiqet fjala: **“rrethanë”** dhe zëvendësohet me fjalët: **“të gjitha rrethanat”**.

Amendamenti 5

Propozimi i deputetes Alma Lama që Neni 37 i Kodit Penal të fshihet në tërësi me përkrahjen e Komisionit funksional

Dy propozime

Amendamenti 6

A. Propozimi i komisionit funksional

Neni 38, bëhet 37, paragrafi 2.2 hiqet dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

B. Propozimi i deputetes Alma Lama pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 38, paragrafi 2 i Kodit Penal të fshihet në tërësi.

Amendamenti 7

Neni 50, riformulohet si vijon: **“Qëllimi i dënimit me kusht është që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë veprë penale.”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 8

Neni 62, paragrafi 2.7, hiqen fjalët: **“marrja e sendit”** dhe fjalës: **“konfiskimi”**, i hiqen **killapat** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 9

Neni 69, paragrafi 1, në rreshtin e fundit, hiqen fjalët: **“nëse janë pronë e kryesit”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 10

Neni 74, paragrafi 2, të shtohet një paragraf i ri 2.12, si vijon: **“Nëse vepra penale kryhet ndaj personit ose grupit të personave, ose pronës, për shkak të origjinës etnike ose kombëtare, shtetësisë, gjuhës, besimeve fetare, ose mungesës së besimeve fetare, ngjyrës, gjinisë, orientimeve seksuale, ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura.”**

dhe paragrafi 2.12, bëhet 2.13 dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 11

Neni 94, paragrafi 3, në rreshtin e tretë, fjalët: **“30 vjet”**, hiqen dhe zëvendësohen me fjalët: **“40 vjet”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Ndërsa **paragrafi 4**, në rreshtin e dytë, hiqen fjalët: **“Ministria e Drejtësisë”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“Këshilli Gjyqësor i Kosovës”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 12

Neni 120, paragrafit 18, i shtohet edhe një nënparagraf **“18.1 nënkupton: oficerët doganorë”**, sipas Kodit Doganor dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 13

Neni 121, shtohet paragrafi 3, si vijon: **“3. Kushdo që me përdorim të dhunës ose me kanosje të dhunës tenton të rrezikojë pavarësinë e Kosovës, sovranitetin dhe integritetin e saj territorial, tërësinë territoriale dhe karakterin demokratik të shtetit, dënohet jo më pak se dhjetë vjet burgim.”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 14

Neni 123, në rreshtin e parë, hiqen fjalët: **“Qytetari i Republikës së Kosovës, i cili”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“Kushdo që”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 15

Pas neni 123 shtohet neni i ri 124 si vijon : titulli **“Tradhtia ndaj vendit;**

1. Kushdo që në cilësinë e Presidentit të Republikës nënshkruan pranimin e okupimit ose aktin e kapitullimit të shtetit dënohet me burgim së paku pesëmbëdhjetë vjet, ose me burgim të përjetshëm.

2. Kushdo që në cilësinë e Presidentit të shtetit nënshkruan marrëveshje ndërkombëtare, ose ndonjë akt me të cilin pjesë të territorit të Republikës së Kosovës jepen ose lihen nën sovranitetin e ndonjë shteti tjetër, dënohen me burgim së paku pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

3. Kushdo që në cilësinë e Presidentit të Republikës së Kosovës e braktis vendin gjatë kohës së luftës, ose gjendjes së jashtëzakonshme duke lënë forcat e armatosura pa sistem të komandimit, dënohet me burgim së paku pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 16

Neni 169, paragrafi 1, në rreshtin e fundit, hiqet fjala: **“dymbëdhjetë”** dhe zëvendësohet me fjalën: **“dhjetë”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Shtohet paragraf i ri 10 pas paragrafit 9, si vijon:

“10.1 Personi i cili rekruton, nxit, organizon, strehon ose bart persona në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, ose në ato të Marrëveshjes Schengen, me qëllim të realizimit dhe të përfitimit ekonomik, social ose të të drejtave të tjera, që janë në kundërshtim me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe me rregullat e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, të Marrëveshjes Schengen dhe të së drejtës ndërkombëtare, dënohet së paku me katër vjet burgim.

10.2 Nëse personi vepron në kundërshtim me paragrafin 10.1 dhe/ose ka qene në dijeni se me bartjen do të realizohen përfitime ose ndonjë të drejte nga paragrafi 10.1, në kundërshtim me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe me rregullat e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, të Marrëveshjes Schengen dhe me të drejtën ndërkombëtare, dënohet prej një deri në pesë vjet burgim.

10.3 Nëse vepra është kryer për përfitime personale, kryesi do të dënohet për veprën, sipas paragrafit 10.1, me burgim, së paku tetë vjet, ndërsa për veprën e kryer, sipas paragrafit 10.2, do të dënohet së paku me katër vjet burgim.

10.4 Nëse vepra është kryer nga personi juridik, do të dënohet me gjobë.

10.5 Pajisjet dhe mjetet transportuese të përdorura për kryerjen e kësaj vepre do të konfiskohen.

10.6 Ky paragraf fillon të zbatohet në momentin kur Këshilli i Bashkimit Evropian merr vendim për heqjen e regjimit të vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës. dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 17

Neni 170, paragrafi 1, në reshtin e fundit hiqet fjala: **“dy”** dhe zëvendësohet me fjalën: **“pesë”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 18

Neni 174, paragrafi 3, në reshtin e fundit, hiqet fjala: **“pesë”** dhe zëvendësohet me fjalën: **“dhjetë”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 19

Neni 178, të shtohet një paragraf i ri si, vijon: **“1.10 Privon nga jeta personin tjetër për motive racore, kombëtare ose fetare.”**

Amendamenti 20

Neni 182, paragrafi 1, hiqen fjalët: **“tre muaj”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“një vjet”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 21

Neni 188, paragrafi 5, rreshti i fundit, hiqen fjalët: **“me burgim prej një deri në pesë vjet”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“jo më pak se tre vjet”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 22

Neni 193, paragrafi 3, në reshtin e fundit, hiqen fjalët: **“jo më pak se dhjetë vjet burgim”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“15 vjet burg ose dënim me burgim të përjetshëm”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 23

Neni 201, paragrafi 1, në rreshtin e fundit, hiqet fjala: “ose” dhe zëvendësohet me fjalën: “dhe” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 2, në rreshtin e fundit, hiqet fjala: “ose” dhe zëvendësohet me fjalën: “dhe”, po ashtu hiqen fjalët: “gjashtë muaj” dhe zëvendësohen me fjalët: “një vjet” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 3, në rreshtin e fundit, hiqen fjalët: “një vit” dhe zëvendësohen me fjalët: “tre vjet” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 4, në rreshtin e fundit, hiqen fjalët: “gjashtë muaj” dhe zëvendësohen me fjalët “një vjet” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Dy propozime Amendamenti 24

A. Propozimi i komisionit funksional

Neni 203, paragrafi 1, në rreshtin e fundit, hiqen fjalët: “gjobë ose me burgim deri në një vit” dhe zëvendësohen me fjalët: “burgim prej një deri në tre vjet”.

Paragrafi 2, në rreshtin e katërt, hiqen fjalët: “gjobë ose me burgim deri në dy vjet” dhe zëvendësohen me fjalët: “burgim prej dy vjet deri në pesë vjet”.

Paragrafi 3, hiqet në tërësi, ndërsa paragrafi 4 bëhet 3 dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

B. Propozimi i deputetit Bekim Haxhiu pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 203 të riformulohet si vijon:

“Përgjimi i paautorizuar”

“1. Kushdo që pa autorizim, përgjon bisedën ose deklaratën, ose i mundëson personit tjetër të jetë në dijeni për bisedën ose deklaratën, që është përgjuar pa autorizim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.”

“2. Kur vepra penale, nga paragrafi 1 i këtij neni, kryhet nga personi zyrtar në keqpërdorim të pozitës ose të autorizimeve të tij, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.”

Dy propozime Amendamenti 25

A. Propozimi i komisionit funksional

Neni 204, paragrafi 1, në rreshtin e fundit, hiqen fjalët: “deri në një vit” dhe zëvendësohen me fjalët: “prej një deri në tre vjet”.

Paragrafi 2, në rreshtin e pestë dhe në të gjashtin, hiqen fjalët: **“gjobë ose me burgim deri në një vit”** dhe zëvendësohen me fjalët **“burgim prej një deri në tre vjet”**.

Paragrafi 3, në rreshtin e fundit, hiqen fjalët: **“tre muaj deri në tre vjet”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“dy vjet deri në pesë vjet”**.

Paragrafi 4, hiqet në tërësi dhe në këtë paragraf kemi një propozim si vijon: **“Nuk ka përgjegjësi penale, nëse fotografimi ose incizimi bëhet me qëllim të zbulimit të veprës penale dhe të kryesit të veprës penale ose për t’i paraqitur si dëshmi në polici, prokurori ose në gjykatë dhe nëse fotografitë dhe incizimet i dorëzohen këtyre organeve.”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

B. Propozimi i deputetit Bekim Haxhiu pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 204 të riformulohet si vijon: **“Fotografimi dhe incizimet e tjera të paautorizuara”**

1. Kushdo që pa autorizim fotografon, filmon, incizon me video ose në ndonjë mënyrë tjetër incizon personin tjetër në banesën e tij personale ose në ndonjë vend tjetër, ku personi ka pritje të arsyeshme për privatësi dhe në këtë mënyrë thellësisht cenon privatësinë e tjetrit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

2. Kushdo që pa autorizim ia kalon, shfaq ose i jep qasje personit të tretë në fotografinë, filmin, videokasetën ose ndonjë incizim tjetër të marrë, në shkelje të paragrafit të këtij neni, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

3. Kur vepra penale, nga paragrafi 1 i këtij neni, kryhet nga personi zyrtar në keqpërdorim të pozitës ose të autorizimeve të tij, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

4. Pasi të jenë paraqitur shkeljet ligjore nga paragrafi 1 dhe 2, procedura penale inicohet *ex officio* nga organet shtetërore.

5. Pajisjet e përdorura për kryerjen e veprës penale nga paragrafi 1 i këtij neni konfiskohen”.

Amendamenti 26

Neni 211, paragrafi 1, në rreshtin e fundit, hiqen fjalët: **“me gjobë ose me burgim”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“prej një viti”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 2, në rreshtin e parafundit, hiqen fjalët: **“me gjobë ose”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 3, në rreshtin e dytë, hiqet numri “2” dhe zëvendësohet me numrin “3”, ndërsa në rreshtin e fundit hiqen: fjalët “**gjashtë muaj**” dhe zëvendësohen me fjalët “**një vjet**”, po ashtu hiqen fjalët: “**tre vjet**” dhe zëvendësohen me fjalët: “**pesë vjet**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 27

Neni 212, paragrafi 1, në rreshtin e parafundit dhe në atë të fundit, hiqen fjalët: “**gjashtë muaj deri në tre vjet**” dhe zëvendësohen me fjalët: “**një deri në pesë vjet burg**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 28

Neni 213, në rreshtin e fundit, hiqet fjala “**një**” dhe zëvendësohet me fjalën “**dy**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 29

Neni 214, paragrafi 1, në rreshtin e parafundit, hiqen fjalët: “**gjobë ose me**”, ndërsa në rreshtin e fundit hiqen fjalët: “**deri në tre vjet**” dhe zëvendësohen me fjalët: “**prej një deri në pesë vjet**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 2, në rreshtin e parafundit, hiqen fjalët: “**gjobë ose me**”, ndërsa në rreshtin e fundit hiqen fjalët: “**deri në tre vjet**” dhe zëvendësohen me fjalët: “**prej një deri në pesë vjet**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 3, në rreshtin e parafundit, hiqen fjalët: “**gjobë ose me**”, ndërsa në rreshtin e fundit hiqen fjalët: “**deri në tre vjet**” dhe zëvendësohen me fjalët: “**prej një deri në pesë vjet**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 4, në rreshtin e fundit, hiqet fjala: “**një**” dhe zëvendësohet me fjalën: “**tre**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 30

Neni 215, paragrafi 1, në rreshtin e parafundit, hiqen fjalët: “**gjobë ose me**”, ndërsa në rreshtin e fundit hiqen fjalët: “**deri në një vit**” dhe zëvendësohen me fjalët: “**prej gjashtë muaj deri në tre vjet**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 2, në rreshtin e fundit, hiqet fjala: “**një**” dhe zëvendësohet me fjalën: “**tre**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 31

Neni 216, paragrafi 1, në rreshtin e parafundit, hiqen fjalët: **“gjobë ose me”**, ndërsa në rreshtin e parafundit, pas fjalës: **“burgim”**, shtohen fjalët: **“prej një”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 2, në rreshtin e parafundit, hiqen fjalët: **“gjobë ose me”**, ndërsa fjalët: **“gjashtë muaj”** zëvendësohen me fjalët: **“një vjet”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 32

Neni 217, paragrafi 1, në rreshtin e parafundit, hiqet fjala: **“gjobë ose me”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 2, në rreshtin e parafundit, hiqet fjala: **“gjobë ose me”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 33

Neni 218, paragrafi 1, në rreshtin e parafundit, hiqen fjalët: **“gjobë ose me”**, ndërsa në rreshtin e fundit hiqen fjalët: **“deri në një vit”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“prej një deri në tre vjet”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 2, në rreshtin e parafundit, hiqet fjala: **“një”** dhe zëvendësohet me fjalën: **“tre”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 34

Neni 219, paragrafi 1, në rreshtin e parafundit, hiqen fjalët: **“gjobë ose me”**, ndërsa në rreshtin e fundit hiqen fjalët: **“deri në një vit”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“prej një deri në tre vjet”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 2, në rreshtin e parafundit, hiqet fjala: **“një”** dhe zëvendësohet me fjalën **“tre”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 35

Neni 229, paragrafi 2, në rreshtin e tretë, hiqet fjala: **“diçkaje”** dhe zëvendësohet me fjalën **“ fakti ”** ndërsa në rreshtin e fundit hiqen fjalët: **“gjashtë muaj deri në pesë vjet”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“ tre deri në dhjetë vjet”**.

Paragrafi 3, në rreshtin e fundit, hiqet fjala: **“tre”** dhe zëvendësohet me fjalën: **“pesë”**. Paragrafi 4.3, në rreshtin e katërt, hiqen fjalët: **“ose viktima tenton të bëjë vetëvrasje pas veprës penale”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 36

Neni 231, paragrafi 1, në rreshtin e parafundit, hiqet fjala: **“dhe”** dhe zëvendësohet me fjalën: **“ose”**, ndërsa në rreshtin e fundit hiqen fjalët: **“prej një deri në pesë vjet”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“deri në një vjet”**.

Amendamenti 37

Neni 240, paragrafi 5, në rreshtin e parë, hiqet fjala: **“or”** dhe zëvendësohet me fjalën: **“ose”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 38

Neni 257, paragrafi 4, në rreshtin e dytë, hiqen fjalët: **“është kryer nga pakujdesia,”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“rezulton me vdekjen e personit”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 39

Neni 264, paragrafi 5, në rreshtin e fundit, hiqen fjalët: **“një deri në tetë vjet”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“dy deri në dymbëdhjetë vjet”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 40

Neni 270, paragrafi 5, në rreshtin e fundit, hiqen fjalët: **“prej një deri në dymbëdhjetë vjet”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“së paku dhjetë vjet”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 8, në rreshtin e tretë, hiqet shifra: **“10.000”** dhe zëvendësohet me shifrën: **“5000”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 41

Neni 272, paragrafi 1, në rreshtin e fundit, hiqet fjala: **“dymbëdhjetë”** dhe zëvendësohet me fjalën: **“tetë”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 2, në rreshtin e parafundit dhe në atë të fundit, hiqen fjalët: **“një deri në tetë”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“dy deri në dymbëdhjetë vjet”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 42

Neni 281, në rreshtin e dytë, hiqet fjala: **“kapitull”** dhe zëvendësohet me fjalën: **“kod”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 43

Neni 301, paragrafi 3, në rreshtin e dytë, hiqet fjala: **“të fshihet”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 44

Neni 304, paragrafi 1, në rreshtin e tretë, hiqen fjalët: **“qarkullimi i të cilave është i ndaluar ose i kufizuar me ligj”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 45

Neni 326, paragrafi 1, në rreshtin e fundit, hiqen fjalët: **“gjashtë muaj deri në pesë vjet”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“tre vjet deri në shtatë vjet”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 2, në rreshtin e fundit, hiqen fjalët: **“një deri në tetë”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“tre deri në dhjetë”**.

Paragrafi 2.1, në rreshtin e fundit, hiqet shifra: **“15.000”** dhe zëvendësohet me shifrën: **“5000”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 46

Neni 327, paragrafi 1, në rreshtin e fundit, hiqet fjala: **“një”** dhe zëvendësohet me fjalën: **“tre”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 2, në rreshtin e fundit, hiqet fjala: **“tre”** dhe zëvendësohet me fjalën: **“pesë”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 3, në rreshtin e fundit, hiqet fjala: **“pesë”** dhe zëvendësohet me fjalën: **“shtatë”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 47

Neni 328, paragrafi 1, në rreshtin e fundit, hiqen fjalët: **“një”** dhe **“dhjetë”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“tre”** dhe **“dymbëdhjetë”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 2, në rreshtin e tretë, hiqet shifra: **“10.000”** dhe zëvendësohet me shifrën: **“5000”** dhe në rreshtin e fundit hiqen fjalët: **“jo më pak se tre vjet”** dhe zëvendësohet me fjalët: **“pesë deri dymbëdhjetë”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 3, në rreshtin e fundit, hiqet fjalët: **“tre”** dhe zëvendësohen me fjalën: **“shtatë”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 4, në rreshtin e fundit, hiqen fjalët: **“pesë”** dhe **“dymbëdhjetë”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“shtatë”** dhe **“pesëmbëdhjetë”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 48

Neni 330, paragrafi 3, në rreshtin e tretë, hiqen fjalët: **“padisë private”** dhe zëvendësohen me fjalën: **“propozimit”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 49

Neni 332, paragrafi 1, në rreshtin e fundit, hiqen fjalët: **“gjashtë muaj”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“një vit”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 2, në rreshtin e fundit, hiqen fjalët: **“gjashtë muaj”** dhe zëvendësohen me fjalët **“një vit”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Të shtohet një paragraf i ri nën 4, si vijon:

“Kur vepra penale nga paragrafi 1 është kryer për shkak të paragjykimeve ndaj kombësisë, gjuhës, besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërin nga këto karakteristika të mbrojtura, kryesi i veprës penale dënohet me burgim deri në tre vjet”.

Amendamenti 50

Neni 345, në titullin e nenit, hiqet fjala: **“veturave”** dhe zëvendësohet me fjalët: **“mjeteve motorike”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 51

Neni 394, në titullin e nenit, hiqen fjalët: **“për krimin e organizuar”**, ndërsa në rreshtin e dhjetë hiqen fjalët: **“krimin e organizuar nga neni 282”** dhe zëvendësohen me fjalët: **“pengimin e procedurës penale”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 52

Neni 408, paragrafi 5, në rreshtin e tretë, pas fjalës: “**gjykatës**”, shtohen fjalët: “, **zyrtarit të prokurorisë**”, në rreshtin e katërt, pas fjalës: “**gjykata**”, shtohen fjalët: “**dhe prokuroria**”, ndërsa pas fjalës: “**policor**”, shtohen fjalët: “**zyrtarit doganor**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 53

Propozimi i deputetes Albulena Haxhiu pa përkrahjen e Komisionit funksional
Neni 410 i Kodit Penal “ **Thirrje për rezistencë** “ të fshihet në tërësi.

Amendamenti 54

Propozimi i deputetit Bekim Haxhiu pa përkrahjen e Komisionit funksional

Në nenin 411 të shtohen paragrafët 3 dhe 4, si vijon:

Paragrafi 3. “**Secili person, që me veprimet e tij të dhunshme ose në ndihmë, ose me pjesëmarrje në veprimet huligane, duke hedhur gjësende në drejtim të personave ose të qytetarëve, të pjesëmarrësve në aktivitet sportiv, ose duke thyer, dëmtuar pajisjet, infrastrukturën publike, ose duke thyer, dëmtuar pajisjet dhe infrastrukturën dhe objektet sportive publike ose private, i vetëm ose në grup të organizuar dhe që ka për qëllim dëmtimin e personave zyrtarë, të pjesëmarrësve sportivë ose të personelit të sigurimit në detyrë zyrtare, në fushat sportive të hapura ose të mbyllura, kryen vepër penale të huliganizmit.**”

Paragrafi 4. “**Për veprën penale, të përcaktuar në nenin 411, paragrafi 3, parashihet dënimi me gjobë prej 200 deri 10.000 Euro për huliganizëm me pasoja të vogla ose me burgim deri në 5 vjet burgim për huliganizëm me pasoja të rënda.**”

Amendamenti 55

Propozimi i deputetit Bekim Haxhiu pa përkrahjen e Komisionit funksional
Bekim Haxhiu.

Në nenin 420 të riformulohet titulli i nenit, si vijon: “**Dëmtimi i varreve, i kufomave dhe abuzimi me kufomat**”

Në nenin 420 të shtohen paragrafët 3 dhe 4, si vijon:

Paragrafi 3. **“Kushdo që abuzon me kufomën, e dëmton qëllimisht atë, ose me qëllim të kënaqjes së epsheve të tij, kryen marrëdhënie seksuale me të vdekurin, kryen veprën penale të marrëdhënies seksuale me të vdekurin ose nekrofili.”**

Paragrafi 4. **“Për veprën penale nga paragrafi 3 i këtij neni, personi kryes i veprës penale, dënohet prej 1 vjet deri në 8 vjet burgim”.**

Amendamenti 56

Të shtohet një nen i ri 436 me përmbajtje dhe titull, si vijon:

Mosraportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare.

1. Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, dhe i cili nuk bën një gjë të tillë, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre vjet. Vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni konsiderohet se është kryer kur deklarata nuk paraqitet brenda afatit për paraqitjen e deklaratës.

2. Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, i cili falsifikon ose nuk paraqet të dhënat e kërkuara në deklaratë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

3. Vlera e padeklaruar e pasurisë, të të ardhurave ose të dobisë tjetër pasurore, e cila është fituar në mënyrë joligjore konfiskohet.

Amendamenti 57

Neni 441, paragrafi 1, në rreshtin e tretë, hiqet fjala: **“hetuar”** dhe zëvendësohet me fjalët: **“mbledhur informacione për”** dhe teksti vazhdon si në Projektligj